



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 1
17.01.2013

NR. VENDIMI 1
16.01.2014

V E N D I M

"NË EMËR TE REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me trup gjykues te perbere prej:

ETLEVA	DEDA	KRYESUESE
LILJANA	BAKU	ANËTARE
BARDHYL	DHAMA	ANËTAR

Asistuar nga sekretari gjyqesor **Besjan HYSI**, ne nje sere seancash gjyqesore, te zhvilluara me dyer te hapura, me seance te fundit te zhvilluar sot me date 16.01.2014, mori ne shqyrtim kerkesen penale Nr. 1 / 6 Akti, date 17.01.2013, qe i perket:

KERKUESE: Prokuroria prane se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, e perfaqesuar nga prokurori **Ened NAKUÇI**.

KUNDER (te paditurve):

1. **F.D.**, i biri i R. dhe S., i dtl. xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx, me shtetesi shqiptare; i perfaqesuar nga avokatet e Dhomes se Avokatise Tirane O.V., me Nr. xxx License, dhe A.Sh., me Nr. xxx License, te emeruar si perfaqesues me prokuren e pergjithshme me Nr. xxx Rep., Nr. xx/x Kol. date xxx, te perpiluar perpara noteres D.B.P.

2. **A.D.**, i biri i F. dhe i N., i dtl. xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx, me shtetesi shqiptare; i perfaqesuar nga avokatet e Dhomes se Avokatise Tirane O.V., me Nr. xxx License, dhe A.Sh., me Nr. xxx License, te emeruar si perfaqesues me prokuren e posacme, te leshuar me date xxx, nga burgu xxx xxx xx xxx, xxxx.
3. **K.D.**, i biri i F. dhe i N., i dtl. xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx, me shtetesi shqiptare; i perfaqesuar nga avokatet e Dhomes se Avokatise Tirane O.V., me Nr. xxx License, dhe A.Sh., me Nr. xxx License, te emeruar si perfaqesues me prokuren e posacme, te leshuar me date xxx, nga burgu i xxx xxx – xxx, xxx.

PERSONA TE TRETE:

1. **A.B.**, i biri i I., i dtl., banues ne xxx, xxx, me shtetesi shqiptare; i perfaqesuar nga avokati i Dhomes se Avokatise Tirane A.Sh., me Nr. xxx License, i emeruar si perfaqesues me deklarim ne seance gjyqesore.
2. **Sh.D.**, i biri i A., i dtl.xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx; i perfaqesuar nga avokati i Dhomes se Avokatise Tirane A.Sh., me Nr. xxx License, i emeruar si perfaqesues me deklarim ne seance gjyqesore.
3. **P.H.**, i biri i S., i dtl. xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx; i perfaqesuar nga avokati i Dhomes se Avokatise Tirane A.Sh., me Nr. xxx License, i emeruar si perfaqesues me deklarim ne seance gjyqesore.

OBJEKTI

: **Konfiskimin e pasurive** si më poshtë:

1. Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxx me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të shtetasit F.R.D.
2. Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxx me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të shtetasit F.R.D.
3. Objekti dy katësh i quajtur ”xxx”, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2,

- e ndërtuar mbi pasuritë e mësipërme me sipërfaqe totale prej xxx m2, e ndodhur në fshatin xxx, Komuna xxx, në afërsi të rrugës nacionale, xxx, përballë xxx, në pronësi të shtetasit F.R.D.
4. Ndërtesë (banesë), dy kate, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit K.F.D.
 5. Ndërtesë (jo banesë), një kat, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit K.F.D.
 6. Ndërtesë (banesë), dy kate, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit A.F.D.
 7. Ndërtesë (jo banesë), një kat, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit në emër të shtetasit A.F.D.

- II.** Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet **z.E.B.**, i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- III.** Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 10192 date 03.12.2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”

Ne diskutimin perfundimtar te ketij gjykimi, te zhvilluar ne prani te prokurorit Ened Nakuci, te perfaqesuesve te shtetasve F.D., K.D. e A.D., avokateve O.V. e A.Sh., si dhe te perfaqesuesit te personave te trete A.B., Sh.D. e P.H., avokatit A.Sh.;

A. Prokurori Ened Nakuci perfundimisht kerkoi:

- Heqjen dore nga gjykimi te kerkese padise ndaj shtetasve F.D., A.D. e K.D., per objektet:
- 1. Pasuria me nr. xxx/xx, volum xx, faqe xx, zone kadastrale xxx me siperfaqe xxx m2, ne pronesi te shtetasit F.R.D..
- 2. Pasuria me nr. xxx/xx, volum xx, faqe xx, zone kadastrale xxx, me siperfaqe xxx m2, ne pronesi te shtetasit F.R.D.
- 3. Objekti dy katesh i quajtur “xxx”, me siperfaqe ndertimi xxx m2, e

ndertuar mbi pasurite e mesiperme me siperfaqe totale prej xxx m2, e ndodhur ne fshatin xxx, Komuna xxx, ne afersi te rruges nacionale xxx-xxx, perballe xxx, ne pronesi te shtetasit F.R.D.

4. Ndertese (banese), dy kate, siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit K.F.D.

5. Ndertese (banese), dy kate, siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit A.F.D.

B. Konfiskimin e pasurive te pershkruara si me poshte:

1. Ndertese (jo banese), nje kat, siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit K.F.D.

2. Ndertese (jo banese), nje kat, siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit A.F.D.

C. Per administrimin dhe perdorimin e ketyre pasurive te ngarkohet **Z. E.B.**, i cili eshte administrator i Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe Konsfiskuara prane Ministrise se Financave – Tirane, ndersa per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohet Zyra e Permbarimit – xxx.

D. Shpenzimet proceduriale si dhe shpenzimet gjyqesore t'i ngarkohen personave te paditur F.D., A.D. dhe K.D.

I jepet fjala prokurorit i cili tha: Eshte bere nje lapsus, duhet ndryshuar tek te dyja kerkesat, tek kerkesa per gjykim dhe tek kerkesat pefundimtare. Behet fjale per ndertesat qe jane dy-kateshe te cilat jane banesa, ndersa ndertesat qe jane nje-kateshe jane jo-banesa. Pra eshte bere nje lapsus, kerkoj te sarktesohet kjo pjese.

-Perfaqesuesit e shtetasve F.D., K.D. e A.D., avokatet O.V. e A.Sh. si dhe perfaqesuesi i personave te trete A.B., Sh.D. e P.H., avokati A.Sh., perfundimisht kerkuan:

– Pushimin e gjykimit persa i perket 5 pasurive per te cilat Prokuroria per Krime te Renda hoqi dore nga gjykimi dhe rrezimin e kerkeses se Prokurorise per Krime te Renda per Konfiskimin e 2 Pasurive si te pabazuar ne prova e ne ligj si dhe heqjen e sekuestros mbi te gjitha pasurite ne fjale.

Gjykata, ne perfundim te gjykimit te ceshtjes,

V E R E N :

Me vendimin nr.9 dt.24.07.2012 kjo gjykate ka vendosur Sekuestrimin e pasurive si me poshte: 1- Pasuria nr.xxx/xx volumi xx faqa xx zona kadastrale xxx me siperfaqe xxx m2 ne pronesi te shtetasit F.D., 2- Pasuria me nr.xxx/xx volumi xx faqa xx zona kadastrale xxx me siperfaqe xxx m2 ne pronesi te shtetasit F.D.. 3- Objekti dy katesh xxx me siperfaqe ndertimi xxx m2 i ndertuar mbi pasurite e mesiperme me siperfaqe totale xxx m2. 4- Ndertese (banese) dy kateshe me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit K.D.. 5- Ndertese (jo banese) nje kateshe me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit K.D., 6- Ndertese (banese) dy kateshe me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit A.D.. 7- Ndertese (jo banese) nje kateshe me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit A.D.

Per administrimin e ketyre pasurive eshte caktuar administratori E.B. si dhe Zyra e Permbarimit xxx per ekzekutimin e ketij vendimi.

Ky vendim eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane me vendimin e saj nr. xx dt. xxx.

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, ka paraqitur prane kesaj gjykate nje kerkese per konfiskimin e pasurive te mesiperme qe u perkasin shtetasve F.D., A.D. e K.D., pasi jane subjekte te hetimit pasuror sipas ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 "Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise".

Shtetasit A.D. e K.D. jane subjekte te zbatimit te ligjit nr.10192 dt 03.12.2009 pasi jane gjykuar e denuar nga gjykatat italiane, Gjykata e xxx me vendimin nr.xx/xx dt.xxx dhe Gjykata e Apelit te Krimeve te Renda te xxx me vendimin nr.x/xx dt.xxx, per krimet e pjesemarrjes ne organizata kriminale, te favorizimit te klandestineve dhe shfrytezimit te prostitucionit me qellim fitimi te disa shtetasve. Aktiviteti kriminal i tyre rezulton te kete filluar ne nisje te vitit xxx dhe ka vazhduar deri ne vitin xxx, ndersa grumbullimi i te ardhurave dhe me pas fillimi i investimeve ne blerjen e trojesh dhe ndertimi i objekteve eshte bere nga babai i tyre, shtetasi F.D. pas vitit xxx deri ne vitin xxx.

Pas fillimit të ndjekjes penale nga autoritetet italiane të shtetasve A.D. dhe K.D., babai i tyre F.D. ka blerë pasurinë me nr. xxx/xx, me sipërfaqe xxx m2, më datë xxx si dhe pasurinë me nr.xxx/xx, me sipërfaqe xxx m2, më datë xxx. Mbi këtë sipërfaqe toke shtetasi F.D. ne vitin xxx ka ndërtuar një objekt x katësh, me emertimin “xxx”, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2. Në këtë objekt shtetasi F.D. ka ngritur një aktivitet tregtar, regjistruar më datë xxx me numër NIPT-i xxx dhe aktivitet xxx, dhe e ka deklaruar për legalizim në Zyrën e ALUIZNI-t xxx.

Shtetasi K.D. ka deklaruar për legalizim një objekt repart pune, magazinë x kat, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi një sipërfaqe të zënë prej xxx m2, e ndërtuar sipas tij në xxx si dhe një objekt banimi x kat me sipërfaqe xxx m2, e ndërtuar sipas tij në vitin xxx.

Shtetasi A.D. ka deklaruar për legalizim një objekt repart pune, x kat, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi një sipërfaqe të zënë prej xxx m2, e ndërtuar (sipas tij) në xxx si dhe një objekt banimi x kat me sipërfaqe xxx m2 e ndërtuar (sipas tij) në vitin xxx.

Me shkresën Nr.xxx/x datë xxx ardhur nga ALUIZNI, Drejtoria e Përgjithshme Tiranë, rezulton se shtetasit F.R.D. dhe A.F.D. kanë aplikuar për legalizimin e pasurive informale pranë Komunës xxx, Qarku xxx.

Me shkresën Nr.xxx/x datë xxx ardhur nga ALUIZNI, Drejtoria Rajonale e Qarkut xxx, rezulton se: Shtetasi F.R.D. ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit informal të ndodhur në xxx duke dorezuar pranë Komunës xxx formularin e vetëdeklarimit nr.xxx datë xxx, ndërtesë (banesë), e perbere nga dy kate, e me sipërfaqe ndërtimi xxx m2, mbi sipërfaqen e truallit prej xxx m2, dhe me vit ndërtimi xxx.

Shtetasi K.F.D. ka aplikuar për legalizim të ndërtimit informal të ndodhur në Xhafzotaj duke dorezuar pranë Komunës xxx:

- Formularin e vetëdeklarimit nr.xxx, datë xxx, ndërtesë (banesë), e perbere nga dy kate, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi sipërfaqen e truallit

prej xxx m2, dhe me vit ndërtimi xxx;

- Formularin e vetëdeklarimit nr.xxx datë xxx, ndërtesë (jo banesë), një kat, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi sipërfaqen e truallit prej xxx m2 dhe me vit ndërtimi xxx.

Shtetasi A.F.D. ka aplikuar për legalizim të ndërtimit informal të ndodhur në xxx duke dorezuar pranë Komunës xxx:

- Formularin e vetëdeklarimit nr.xxx, datë xxx, ndërtesë (banesë), e perbere nga dy kate, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi sipërfaqen e truallit prej xxx m2 dhe me vit ndërtimi xxx;
- Formularin e vetëdeklarimit nr.xxx datë xxx, ndërtesë (jo banesë) një kat, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2 mbi sipërfaqen e truallit prej xxx m2 dhe me vit ndërtimi xxx.

Me shkresën Nr.xxx/x datë xxx derguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Renda Tirane nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx rezulton se shtetasi F.R.D. ka të regjistruar këto pasuri:

- Pasuria me nr.xxx/x, volum xx, faqe xxx, zonë kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m2;
- Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m2;
- Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxx, me sipërfaqe Xxx m2.

Në kuader të hetimit pasuror, në datë xxx, nga prokuroria është kryer kqyrja dhe marrja e dokumentacionit të regjistrimit të pasurive në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx në emër të shtetasit F.D. për pasuritë sipas proces - verbalit të këqyrjes dhe marrjes së dokumentave, të mbajtur më datë xxx, për pasuritë të identifikuara si më poshtë vijon:

1. Pasuria me nr.xxx/x, volumi xx, faqe xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi Nr.xxx datë xxx përfituar sipas ligjit “Për tokën” Nr.7501 datë 19.07.1991.
2. Pasuria me nr.xxx/xx, volumi xx, faqe xx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar sipas kontratës së shit-blerjes Nr. Rep.

xxx, Nr. Kol. xxx datë xxx, sipërfaqe prej xxx m2 dhe me vlerë totale të kontratës prej xxx lekë.

3. Pasuria me nr.xx/xx, volumi xx, faqe xx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m2, regjistruar sipas kontratës shit-blerjes Nr.Rep xxx, Nr. Kol. xxx datë xxx dhe me vlerë totale të kontratës prej xxx lekë.

Me qëllim verifikimin e të ardhurave të familjarëve të shtetasve F.D., A.D. dhe K.D. nga organi i akuzes janë verifikuar dhe vlerat e monetare të depozituara në Bankat e ndryshme të nivelit të dytë.

1. Me shkresën Nr. xxx/x datë xxx te xxx Bank rezulton se shtetasi F.D. është klient dhe ka një llogari rrjedhëse në lekë me nr. xxx, me gjendje aktuale xxx lekë. Gjithashtu shtetasit F. dhe N.D. kanë patur llogari në lekë me nr. xxx. Më datë xxx, shuma prej xxx lekë ka kaluar me anë të një transferte në llogarinë me nr. xxx të shtetasës N.D. dhe gjendja aktuale është xxx lekë.
2. Me shkresën Nr. xxx datë xxx te xxx Bank rezulton se shtetasi F.R.D. ka llogari rrjedhëse në lek, me balancë aktuale xxx lekë, shtetasi K.F.D. ka llogari rrjedhëse në usd. dhe në euro, secila prej tyre me balancë aktuale xxx xxx. dhe xxx xxx.

Me shkresën me Nr.xxx/x Prot. datë xxx te Q.K.R. xxx rezulton se shtetasi F.R.D. figuron i regjistruar si person fizik në Q.K.R. më datë xxx, identifikuar me NIUS (NIPT) xxx, me vend ushtrimi të aktivitetit xxx, xxx, ndërtesë xkatëshe, kati i parë, xx metra larg xxx dhe me fushë veprimtarie Bar-Bufe.

Ne seance gjyqesore perfaqesuesit e te paditurve pretenduan se pasurite mbi te cilat eshte vendosur sekuestro nga kjo gjykate kane prejardhje te ligjshme, se ato jane frut i punes legale te te paditurve si dhe i borxheve, detyrimeve te marra nga ata tek shtetasit **A.B., Sh.D. e P.H.**

Per kete arsye nga kjo gjykate u vendos thirrja dhe futja ne kete proces me cilesine e personave te trete dhe e ketyre tre shtetasve me qellim verifikimin e vertetesise se kredive, huave te pretenduar dhene prej tyre, mundesise reale te

tyre per te disponuar kete pasuri, vlere monetare dhe faktin nese kjo pasuri pretenduar se disponohej prej tyre a ka preardhje legale.

Gjithashtu nga kjo gjykate per ti dhene pergjigje pretedimeve te te paditurve dhe personave te trete lidhur me prejardhjen e ligjshme te pasurive te sekuestruara eshte vendosur dhe kryerje e ekspertimit vleresues te ketyre pasurive si dhe ekspertimi kontabel, financiar i te ardhurave te te paditurve dhe personave te trete te futur ne kete proces.

Keshtu nga akti i ekspertimit vleresues i perpiluar nga eksperte vleresuese M.F. jepet si konkluzion se :

- 1- Vlera e objektit Bar Restorant Hotel “ xxx” me siperfaqe ndertimi xxx m2 me punime te kryera ne vitin xxx eshte xxx leke.
- 2- Vlera e objektit dy katesh (banese) me siperfaqe ndertimi xxx m2 per punime te kryera ne vitin xxx eshte xxx leke.
- 3- Vlera e objektit nje katesh (jo banese) magazine duralumini me siperfaqe ndertimi xxx m2(ne fakt xxx m2) per punime te kryera ne vitin xxx eshte xxx leke.
- 4- Vlera e objektit dy katesh (banese) me siperfaqe ndertimi xxx m2 per punime te kryera ne vitin xxx eshte xxx leke.
- 5- Vlera e objektit nje katesh (banese) magazine servis automjetesh me siperfaqe ndertimi xxx m2 (ne fakt xxx m2) per punime te kryera ne vitin xxx eshte xxx leke.

Vlera totale e te gjithe ketyre pasurive rezulton te jete xxx (xxx) leke.

Sipas aktit te ekspertimit vleresues, sqarohet se ne kete akt metoda e perdorur eshte ajo e kostos si dhe cmimet sipas vitit te ndertimit te objektit. Ekspertimit kontabel iu nenshtruan dhe te ardhurat e te paditurve pasi u pretendua se pasurite e mesiperme jane vene me te ardhura te ligjshme te tyre.

Keshtu sipas aktit te ekspertimit kontabel bere nga eksperti Gj.H., jepet si konkluzion qe:

- 1- Nga provat ne dosje nuk ka asnje suate financiare te te paditurve ne xxx te vitit xxx (kur ka filluar aktiviteti kriminal). Ne keto kushte pretendimi i te paditurve se kane ushtruar aktivitet si shites mishi qe

perpara kesaj periudhe, qe nga janari i vitit xxx e ne vazhdim mbetet i pambeshtetur. Gjithsesi eksperti, ne mungese te dokumentacionit perkates financiar te ketij aktiviteti, mendon se te ardhurat neto vjetore nga ky aktivitet mund te ishin ne shumen xxx leke. E shumezuar kjo shifer me periudhen vjetore prej xxx vjet, eksperti mendon se nga ky aktivitet deri ne xxx xxx, te ardhurat mund te ishin ne shumen xxx leke. **Eksperti sakteson se ky eshte vetem nje opinion i tij** per te interpretuar situaten financiare deri ne kete periudhe.

2- Per te percaktuar te ardhurat e mundshme te te paditurve per periudhen nga muaji xxx xxx deri ne xxx xxx, ne aktin e ekspertimit eksperti permend se bazohet ne:

A- Te ardhurat nga huate ne shumen gjithsej xxx leke marre nga personat e trete sipas deklarave noteriale nr.xxx rep. xxx kol dt.xxx dhe nr.xxx rep. xxx kol. Dt.xxx. Kete shume eksperti ne aktin e ekspertimit e ka konsideruar si te ardhur per te paditurit.

B- Te ardhurat nga shitja ne shumen xxx leke. Ketu jane patur per baze kontratat e shitjes nr.xxx rep. xxx kol., dhe nr.xxx rep. xxx kol.Dt.xxx ku eshte shitur toke are.

3- Te ardhurat nga depozitat bankare ne shumen xxx leke. Nga shkresat e ardhura nga xxx Bank nr.xxx rezulton se i padituri F.D. ka patur nje llogari ne kete banke ne shumen xxx leke te cilen e ka terhequr ne dt.xxx e gjithashtu nje depozite dy emerore ne shumen xxx leke te cilen e ka terhequr ne dt.xxx.

4- Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar ne tre aktivitete: a- prodhim profilesh alumini; b- prodhim vreshtarie; c- aktivitet shitje mishi.

a- Aktiviteti i prodhimit te profilit te aluminit rezulton qe te kete filluar ne vitin xxx. Ai eshte miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor xxx me vendimin nr.xxx dt.xxx dhe eshte regjistruar dhe ne organet e tatim taksave. Ne dy vitet e para te ketij aktiviteti, eshte deklaruar nje xhiro vjetore prej xxx lekesh me nje koeficient te ardhurash neto prej xx. Keshtu qe per kete periudhe prej dy vjetesh te ardhurat e realizuar jane xxx. leke. Pas kesaj periudhe dy vjecare deklarimi te xhiros nuk disponohet me dokumentacion rreth aktivitetit financiar te mesiperm qe do te sherbente si pike referimi per te llogaritur te ardhurat. Vete eksperti i ka perllogaritur te ardhurat ne aktin e tij te ekspertimit deri ne xxx (pavaresisht mungeses se dokumentacionit)

dhe shumezuar me kooficentin e permendur me lart prej xxx, sipas tij te paditurit nga ky aktivitet do te kishin mundur te realizonin te ardhura ne shumen xxx leke.

- b- Aktiviteti i prodhimit te vreshtarise eshte zhvilluar ne nje siperfaqe toke prej xxx m2 e kthyer ne vreshtari ne vitin xxx. Sipas vertetimit te Komunes ku banojne te paditurit i dhene per kete rast, jepet se rendimenti i te paditurve ne kete aktivitet ka qene xx kv per dynym. Nisur nga keto te dhena eksperti ne aktin e tij te ekspertimit vleresues ka arritur ne konkluzioni se nga ky aktivitet te paditurit kane realizuar te ardhura ne shumen prej xxx leke.
- c- Aktiviteti i shitjes se mishit i llogaritur nga eksperti, eshte pretenduar nga te paditurit se eshte zhvilluar ne nje ambient te marre me qera nga shtetasi S.M.. Ambienti eshte xx m2 dhe sipas pretendimit te te paditurve ky aktivitet eshte zhvilluar ne vitet xxx deri ne xxx. Dokumentacion per kryerjen e ketij aktiviteti nga te paditurit nuk eshte paraqitur, nuk disponohet. I vetmi akt eshte deklarata noteriale e qiradhenesit nr.xxx rep xxx/x kol. dt.xxx. Duke mos disponuar asnje dokumentacion mbi bazen e te cilet do te behej vleresimi i aktivitetit trgtar te pretenduar, eksperti ne aktin e tij te ekspertimit vleresues eshte shprehur se **nje mesatare e mundshme** e te ardhurave **qe mund te realizoheshin** nga ky aktivitet, eshte ne shumen xxx leke.

Nga te ardhurat e perllogaritura vec e vec nga eksperti ne aktin e tij vleresues, rezulton nje shifer te ardhurash ne shumen totale xxx leke.

Si detyre e ekspertit ka qene dhe perllogaritja e shpenzimeve te bera nga te paditurit dhe familjet e tyre per periudhen nga viti xxx deri ne vitin xxx. Sipas aktit te ekspertimit rezulton qe shpenzimet e mundshme te te paditurve dhe familjes se tyre per kete periudhe kapin shumen prej xxx leke ku eshte perfshire dhe shuma prej xxx lekesh per blerje toke. Ne llogaritjen e shpenzimeve te te paditurve dhe familjes se tyre nga eksperti eshte patur si baze minimumi jetik.

Objekt i ekspertimit kontabel ka qene dhe pasuria e personave te trete ne kete gjykim, per te llogaritur te ardhurat dhe shpenzimet e tyre me qellim verifikimin e preardhjes apo jo te ligjshme te pasurise se tyre ne kushtet kur pretendohej se u kishin dhene hua shuma te konsiderueshme te paditurve.

Pas kryerjes se dy akteve te ekspertimit, prokurori bazuar ne to, arriti ne konkluzionin se te paditurit me te ardhurat e realizuara, justifikojne shumat e parave te harxhuara per blerjen e trojeve dhe ndertimin e objekteve: “ xxx”; ndertese dy kateshe (banese) me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te K.D.; ndertese dy kateshe (banese) me siperfaqe xxx m2 ne emer te A.D.. Per keto arsye ai hoqi dore nga gjykimi i kerkes padise per sa u perket ketyre objekteve, pronave, duke kerkuar konfiskimin vetem per objektet ndertese nje kateshe jobanese me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit K.D. dhe ndertese nje kateshe jobanese me siperfaqe ndertimi xxx m2 ne emer te shtetasit A.D.

Per sa i perket perfaqesuesve te te paditurve pas kryerjes se akteve te eksperetimit dhe ne konkluzionet e tyre perfundimtare, ata pretenduan se te ardhurat e realizuara nga te paditurit justifikojne dhe mbulojne te gjitha shpenzimet e bera per blerjen e ndertimin e objekteve per te cilat eshte paraqitur kerkesa e konfiskimit. Per rrjedhim ata kerkojne rrezimin e kerkeses per konfiskim dhe heqjen e mases se sekuestros vene mbi keto prona.

Lidhur sa u kerkua dhe pretendua nga palet ne konkluzionet e tyre perfundimtare, gjykata vlereson se duhet ngritur per diskutim ceshtjet: 1- Nese prokurori ne kete lloj te vecante gjykimi ku nderthuret zbatushmeria e disa ligjeve a mund te veproje si nje padites i mirefillte. 2- nese heqja dore nga prokurori nga gjykimi i kerkeses do ta coje detyrimisht gjykatën ne nje vendimmarrje per pushimin e gjykimit te kerkeses konform nenit 201 te K.Pr.Civile apo kjo kerkesë e prokurorit duhet te nderthuret me nje analize te plote e te bazuar te provave te marra nga gjykata per te legjitimuar nje kerkesë te tille.

- 1- Per sa i perket ceshtjes se pare, gjykata cmon se ne kete lloj te vecante gjykimi, prokurori nuk ka teger dhe nuk mund te sillet si nje padites i

zakonshem. Rregullat ne lidhje me gjykimin e ceshtjes se sekuestrimit apo konfiskimit, parashikohen specifikesht ne ligjin e posacem nr.10192 dt.3.12.2009. Ky ligj i ka njohur, dhene, prokurorit jo vetem te drejten por njekohesisht dhe detyrimin e tij per te paraqitur ne keto raste kerkese ne gjykate. Pra ai nuk mund te sillet si nje padites i zakonshem qe e ka ne vullnet te tij paraqitjen apo jo te nje kerkese padije pasi ai paraqitjen e kerkeses e ka dhe detyrim ligjor. Ligji i mesiperm nuk e ka njohur prokurorin si pronar te pasurive per te cilet ka paraqitur kerkese, madje dhe administrimin e tyre ia le nje tjeter enti. Vete prokuroria nuk mund te disponoje mbi keto pasuri, nuk mund ti shese, dhuroje, tjetersoje ato, te drejta te cilat do te mund ti kishte nese do te konsiderohej nje padites i zakonshem. Nese prokurori do te konsiderohej nje padites i zakonshem sipas K.Pr.Civile, atij mund ti njihet dhe tagri i heqjes dore nga e drejta e padise sic parashikon neni 201/2 i K.Pr.Civile. Gjykata cmon se duke mos u konsideruar si nje padites i zakonshem edhe e drejta per te hequr dore nga gjykimi i kerkeses nuk mund ti njihet prokurorit si tager i pavarur nga ecuria e gjykimit, bazushmeria ne provat e marra ne gjykim. Vete qellimi i ligjit, i parashikuar ne nenin 2 te tij eshte “ parandalimi dhe goditje ndaj krimit te organizuar dhe trafikimit, permes konfiskimit te pasurise se personave...” Me ane te ketij ligji, ligjevenes i eshte kundervene krimit te organizuar duke forcuar masat e pershtatshme per te luftuar me efikasitet kete fenomen duke konfiskuar pasurite, asetet, e rrjedhura nga aktiviteti kriminal veprim i cili do te kishte efikasitet edhe ne zvogelimin e pasurive, aseteteve te financimit te aktiviteteteve kriminale me pasoje uljen e veprimtarise kriminale.

Ne nenin 5/2 te ligjit te mesiperm eshte percaktuar se : *verifikimet, hetimet dhe gjykimi sipas ketij ligji, mbeshtetet ne rregullat proceduriale te ketij ligji dhe **plotesohen** nga rregullat e percaktuara ne K.Pr.Civile.* Gjithashtu dhe ne nenin 22/1 te ketij ligji qe ben fjale per proceduren gjyqesore te konfiskimit, eshte saktësuar se: *gjate gjykimit te kerkeses per konfiskim zbatohen, **per aq sa eshte e mundur** dispozitat e K.Pr.Civile.*

Nga keto dy dispozita te ligjit te posacem, eshte saktësuar se ne proceduren e gjykimit te kerkeses, perparesi kane rregullat e percaktuara ne ligjin e posacem dhe dispozitat e K.Pr.Civile zbatohen per aq sa eshte e mundur. Gjykata cmon se te tilla gjykime, interesi publik duhet te prevaloje mbi cdo kerkese tjeter.

- 2- Per sa i perket pikes se dyte, gjykata cmon se jo patjeter heqja dore e

prokurorit nga gjykimi i kerkeses do ta coje detyrimisht gjykatën në një vendimmarrje për pushimin e gjykimit të kerkeses konform nenit 201/1 të K.Pr.Civile pasi kjo kerkese e prokurorit duhet të nderthuret me një analizë të plote e të bazuar të provave të marra në gjykim të cilat duhet të justifikojnë qëndrimin e tij rreth kerkeses, pasi nuk është disponuar për një pasuri personalisht të tijen.

Në rastin konkret, prokurori në konkluzionet e tij në të cilat ka paraqitur dhe kerkesen për heqje dore, është mbështetur totalisht në definicionet e ekspertit kontabel, duke i marrë të mirëqena ato pa kurrfarë analize e duke treguar një “bonsens abuziv” ndaj të paditurve.

Edhe të paditurit, perfaqësuesve të tyre, në konkluzionet e paraqitura nuk bëjnë asnjë analizë të aktit të ekspertimit kontabel, për faktin se sa i bazueshem mund të jete ai, duke u ardhur për shtat dhe konkluzioni, kerkesa e prokurorit për heqje dore.

Gjykata pasi analizoi aktin e ekspertimit kontabel, konstaton se kerkesa e prokurorit për heqje dore nga gjykimi i kerkeses për shumicën e pasurive, është totalisht e pabazuar në ato cka eksperti ka përlogaritur e që mund të konsiderohen konkluzione të bazuara në prova perkatese, të ekspertit.

Kështu, për sa i përket pikës së parë të detyrave të ekspertit, se cila ka qenë situata financiare e të paditurve në muajin xxx xxx nisur provat e marra në gjykim, eksperti ka sqaruar se: ***nga provat e dosjes nuk kemi një gjendje të trashëguar apo të bartur që të paraqesë një situatë financiare reale të të paditurve në këtë moment.*** Pergjigja e dhënë prej tij pas një llogaritje hipotetike është që: të ardhurat nga ky aktivitet (dyqan shitje xxx) mund të ishin në shumën xxx leke. Me tej po për këtë detyrë, eksperti sqaron se: ***Në pergjigje të kësaj pyetje mund të paraqesim vetëm një opinion të interpretuar që situata financiare e mbartur është në këtë shumë.***

Vetë prokurori për këtë pergjigje, nuk analizon asgjë, lidhur me mënyrën e kryerjes së aktit të ekspertimit, metodat e përdorura, madje as shpjegimet e ekspertit ku ai shprehet se paraqet vetëm një opinion të interpretuar të gjendjes financiare dhe jo një konkluzion të bazuar në prova.

Gjykata cmon te theksoje se eksperti eshte thirrur dhe caktuar nga gjykata per te kryer nje detyre pasi ai disponon njohuri te posacme ne nje fushe te caktuar dhe gjykata dhe palet do te bazoheshin vetem ne konkluzionet e dhena prej tij dhe jo ne opinionet sikurse ne rastin konkret. Per rrjedhim shuma ne para prej xxx leke, e dhene nga eksperti si e ardhur qe mund te ishte, me sqarimin se ky eshte vetem nje opinion i interpretuar prej tij, nuk mund te konsiderohet e mireqene nga gjykata dhe nuk do te llogaritet si e ardhur per palen e paditur.

- Eksperti ka llogaritur si te ardhura per palen e paditur shumat e marra hua nga personat e trete, ne shumen gjithsej xxx leke e cila eshte pranuar e mireqene nga prokurori pa analizuar vertetesine e tyre apo faktin qe me te vertete keto para jane perdorur per te vene pasurite qe kerkohen te konfiskohen. Per kete konkluzion eksperti eshte bazuar ne deklaratat noteriale te huadhenesve, te dateve xxx dhe xxx te cilat ndodhen ne dosjen gjyqesore.

Sic eshte sqaruar dhe me lart ne kete vendim, pasurite per te cilat eshte kerkuar konfiskimi jane vene nga te paditurit disa vite perpara perpilimit te dy akteve noteriale te mesiperm. Shuma e pretenduar nga te paditurit si e marre hua, nuk ka sherbyer per te vene keto pasuri pasi ne kete moment ato ekzistonin, ishin vene nga te paditurit. Perpilimi i ketyre akteve noteriale, kohe me vone se venia e pasurise nga te paditurit, por prane ne kohe me momentin e regjistrimit te procedimit ndaj tyre, gjykata cmon se eshte vetem nje perpjekje “jo fort e holle” nga te paditurit per te gjetur nje menyre justifikimi per pasurite objekt konfiskimi dhe ajo nuk do te llogaritet si e ardhur per palen e paditur.

- Eksperti ka konsideruar si te ardhura te te paditurve dhe te ardhurat nga shitjet ne shumen xxx leke bazuar kjo ne dy akte noteriale qe mbajne daten xxx, shume kjo e pranuar e mireqene nga prokurori pa analizuar faktin qe me te vertete keto para jane perdorur per te vene pasurite qe kerkohen te konfiskohen. Sic eshte sqaruar dhe me lart ne kete vendim, pasurite per te cilat eshte kerkuar konfiskimi jane vene nga te paditurit perpara perpilimit te dy akteve noteriale te mesiperm. Shuma e pretenduar nga te paditurit si e ardhur nga shitja, nuk ka sherbyer per te vene keto pasuri pasi ne kete moment ato ekzistonin, ishin vene nga te paditurit dhe ajo nuk do te llogaritet si e ardhur per palen e paditur.

-Eksperti ka llogaritur si te ardhura per te paditurit edhe depozitat bankare

ne dy depozita, ne shumen gjithsej xxx leke. Nga aktet e dosjes rezulton qe i padituri F. ka patur nje llogari bankare ne xxx Bank ne shumen xxx leke te cilen e ka mbyllur ne dt.xxx dhe nje depozite kursimi dyemere po ne kete banke ne shumen xxx leke te cilen e ka mbyllur ne dt.xxx. Gjykata cmon qe keto para qe disponoheshin nga te paditurit ne vitin xxx, xxx, nuk mund te konsiderohen si te ardhura qe kane sherbyer per te vene pasurine objekt konfiskimi pasi kjo pasuri ne kete periudhe ishte vene nga te paditurit. Keto para nuk kane sherbyer per venien e pasurise objekt konfiskimi pasi ato vete kane qene te depozituara ne banke e nuk jane perdorur per ndonje qellim. Ekzistenca e ketyre parave eshte e qarte por mbete e pazbardhur se mbi cfare aktiviteti i padituri F. i ka vene keto para, a justifikohet ligjishmeria e tyre prej tij pasi nuk rezulton ndonje aktivitet ekonomik apo tregtar nga i cili ai te kete vene nje shume te tille te madhe parash. Gjithashtu duhet te kemi parasysh dhe preteelimin e permendur me lart nga te paditurit, qe ata jane borxhlinj, debitore tek personat e trete ne shumen xxx leke ne kete kohe gje qe bie ne kundërshti me pretendimin tjetër te tyre se po ne te njejtën periudhë kur kane qene debitore, kane patur llogari bankare ne shumen xxx leke. Ne kete pike gjykata ngelet e paqarte se per cfare arsye keto llogari bankare nuk jane gjetur, identifikuar, bllokuar e sekuestruar kur ato kane ekzistuar ne kohen kur procedimi pasuror ishte regjistruar. Per sa me lart, gjykata cmon se shuma e pretenduar nga te paditurit si e ardhur nga depozitat bankare, nuk ka sherbyer per te vene keto pasuri pasi ne kete moment ato ekzistonin, ishin vene nga te paditurit dhe ajo nuk do te llogaritet si e ardhur per palen e paditur.

-Eksperti ka llogaritur si te ardhur nga aktiviteti tregtar shumen prej xxx leke. Ne kete aktivitet ai ka llogaritur, te ardhurat nga 3 aktivitete, a-prodhim profilesh alumini; b- prodhim vreshtarie; c- shitje mishi.

A) Per sa i perket aktivitetit te prodhimit te aluminit, sipas ekspertit, te ardhurat jane ne shumen xxx leke, llogaritur per periudhen nga xxx deri ne xxx.

Nga aktet e dosjes, gjykata konstaton se ky aktivitet ka filluar ne vitin xxx, i regjistruar ne gjykate dhe ne tatime. Ne dy vitet e para te ketij aktiviteti eshte deklaruar ne organin perkates xhiroja e tij e cila mund te sherbeje si baze per te nxjere te ardhurat e realizuara. Sipas deklarimit te

xhiros vjetore, ajo eshte ne shume xxx leke. Kjo eshte nje e ardhur bruto sic ka sqaruar dhe ekspertit dhe e ardhura neto per kete shifer shumezohet me koeficientin 0,4. Per rrjedhim e ardhura neto ne vit kap shumen xxx leke.

Ne shifren xxx leke, e nxjerre nga ekspertit per te ardhurat nga ky aktivitet, ekspertit e ka shtrire llogaritjen per kete aktivitet ne nje periudhe kohore prej xx muajsh, xxx vite. Nderkohe sic u tha dhe me lart, vetem ne dy vite eshte deklaruar xhiroja vjetore e ketij aktiviteti dhe gjykata cmon se eshte e paarsyeshme e pabazuar qe te shtrihet ne kohe me te gjate se deklarimi i bere ky aktivitet. Perderisa vetem per dy vjet te ketij aktiviteti eshte bere deklarimi perkates, gjykata cmon se kjo duhet te jete dhe periudhe ne te cilen do te llogariten si te ardhura per te paditurit aro te fituara nga ky aktivitet. Te ardhurta totale per dy vjet te ketij aktiviteti kapin shumen xxx leke(x vit- xxx te ardhura).

B) Te ardhurat nga vreshtaria, sipas ekspertit kapin shumen xxx leke.

Nga aktet e ndodhura ne dosje (Vertetimi i Komunes xxx), mbi te cilat eshte bazuar ekspertit, rezulton qe te paditurit kane nje siperfaqe toke prej xxx m² nga te cilat nje siperfaqe toke prej xxx m² e kane kthyer ne vreshtari. Kjo vreshte eshte krijuar ne vitin xxx dhe rendimenti i saj ka qene ne kuoten xx kv per dynym. Ne aktin e tij te ekspertimit, ekspertit ka perllogaritur sasine e prodhimit te marre sipas rendimentit te mesiperm, kohezgjatjen ne xxx muaj te ketij aktiviteti, cmimin mesatar te shitjes, nga ku kane rezultuar si e ardhur vjetore shuma xxx leke dhe si e ardhur per te gjithë periudhen shuma prej xxx leke.

Gjykata konstaton se nga ana e ekspertit nuk jane patur parasysh ne perllogaritje i shpenzimeve te bera per kete aktivitet, i shpenzimit fillestar dhe i shpenzimeve periodike qe kerkon ky aktivitet. Gjithashtu nuk eshte patur parasysh qe kjo kulture(rrushi) ne cfare kohe ne raport me mbjelljen e saj hyn ne prodhim.

Megjithkete gjykata cmon ta marre te mireqene konkluzionin e ekspertit e te llogarise se te ardhura per te paditurit shumen e llogaritur prej tij per aktivitetit vreshtari, ne shumen gjithsej xxx leke.

C) Te ardhurat nga aktiviteti i shitjes se mishit, sipas ekspertit kapin shumen xxx leke e pranuar si e mireqene nga prokurori. Sipas ekspertit, dokumentacioni i vetem qe bazohet ne llogaritjet e tij eshte nje deklarate noteriale e dt.xxx ne te cilen sqarohet se shtetasi S.M. i ka dhene te paditurit F. me qera nje dyqan xx m² per shitje mishi ne periudhen xxx-

xxx.

Gjykata cmon se eshte e pamundur, e pabazuar e pallogjike, te llogarisesh nje aktivitet ekonomik vetem mbi bazen e nje akti per dhenie me qera te nje ambienti, dyqani, akt i cili per me teper eshte perpiluar afer 10 vjet pas veprimit te pretenduar, dhenies me qera. Ne kete gjykim eshte plotesisht e pavartetuar qe i padituri F. te kete patur nje dyqan me qera, plotesisht e pavartetuar qe ai ne kete dyqan te kete ushtruar nje aktivitet, qe ky aktivitet te jete ai i shitjes se mishit. Jane vetem pretendimet e te paditurve qe e ngrejne nje gje te tille. Nuk rezulton asnje akt qe aktiviteti i pretenduar te kete ekzistuar, te jete regjistruar ne gjykate, tatime, te kete bere deklarime etj te cilat mund te sherbejne si baze per te llogaritur te ardhura. Gjykata cmon se perllogaritje si e ardhur e bere nga eksperti per nje aktivitet ekonomik, i cili nuk provohet se ka ekzistuar, nuk mund te pranohet per tu konsideruar si e ardhur per llogari te te paditurve.

Nisur nga ato qe gjykata i pranoi si te ardhura te vertetuara per te paditurit, te ardhurat nga vreshtaria ne shumen xxx leke dhe ato nga prodhimi i aluminit per nje periudhe dy vjecare ne shumen xxx leke, rezulton qe te ardhurat e te paditurve per periudhen xxx-xxx, kapin shumen xxx leke.

Nga eksperti jane llogaritur dhe shpenzimet e nevojshme te te paditurve dhe familjes se tyre per periudhen e viteve xxx-xxx. Sipas aktit te ekspertimit kontabel, jepet si konkluzion se shpenzimet e te paditurve dhe familjes se tyre per kete periudhe, kapin shumen prej xxx leke.

Duke patur parasysh aktin e ekspertimit vleresues, ku ka rezultuar se vlera totale e objekteve, pronave qe kerkohet te konfiskohen eshte xxx leke dhe sasine e te ardhurave qe u provua se te paditurit kishin realizuar ne shumen gjithsej xxx leke (dhe pa u perfshire fare shpenzimet e tyre), konstatohet dukshem nje dinivel, nje diference e jashtezakonshme, qe detyrimisht te con ne konkluzionin se keto pasuri qe kerkohet te konfiskohen, nuk jane vene me te ardhura te ligjshme nga te paditurit. Rrjedhimisht bazuar ne nenin 24 te ligjit nr.10192 dt.3.12.2009, gjykata cmon se **te gjithë keto pasuri duhet te konfiskohen.**

PER KETO ARSYE

Gjykata, në bazë të neneve, 3, 5, 7, 14, 15, 22, 23, 24, 28-38 të ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”;

V E N D O S I:

I. Konfiskimin e pasurive si më poshtë:

1. Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxxx me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të shtetasit F.R.D.
2. Pasuria me nr.xxx/xx, volum xx, faqe xx, zonë kadastrale xxxx me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të shtetasit F.R.D.
3. Objekti dy katësh i quajtur ”xxx”, me sipërfaqe ndërtimi xxx m2, e ndërtuar mbi pasuritë e mësipërme me sipërfaqe totale prej xxxx m2, e ndodhur në fshatin xxx, Komuna xxx, në afërsi të rrugës xxx, xxx-xxx, përballë xxx, në pronësi të shtetasit F.R.D.
4. Ndërtesë (banesë), dy kate, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit K.F.D.
5. Ndërtesë (jo banesë), një kat, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit K.F.D.
6. Ndërtesë (banesë), dy kate, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit A.F.D.
7. Ndërtesë (jo banesë), një kat, sipërfaqe ndërtimi xxx m2, në emër të shtetasit në emër të shtetasit A.F.D.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet z.E.B., i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit xxx.

Shpenzimet proceduriale dhe ato gjyqesore i ngarkohen shtetasve F.D., A.D. e K.D.

IV. Kunder këtij vendimi, mund të bëhet apel në Gjykatën e Apelit për Krime

te Renda Tirane, nga palet ne proces, brenda afatit ligjor.

U shpall sot ne Tirane me date 16.01.2014.

SEKRETAR
Besjan HYSI

GJYQTARE
Etleva DEDA